



Raport 2007

Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës - CCDO

Nëse Gjirokastra u njoh zyrtarisht nga “bota” për vlerat e saj më 2005, (me pranimin në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s,) ajo nisi të vizitohet nga “bota” më 2007-ën. Qyteti i gurtë po pret tani jo vetëm një numër në rritje turistësh shqiptarë dhe të huaj, por edhe shumë studiues e specialistë restaurimi, të interesuar për ta kuptuar qytetin sa më mirë.

Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës – GCDO ndjehet krenare për kontributin e zellshëm që ajo ka dhënë gjatë vitit 2007, vit të cilin ne e konsiderojmë një pikë kthese në shpëtimin e vlerave të Gjirokastrës së gurtë.

GCDO i përqendroi përpjekjet e saj në konservimin dhe ruajtjen e qytetit, ndërkohë që ofroi shërbime dhe infrastrukturë aq shumë të nevojshme për turizmin lokal në rritje. Po ashtu përpjekje u bënë për një gamë të gjerë veprimtarish për të rigjallëruar interesimin e banorëve për qytetin e tyre.

Fondacioni ynë veprimtar si një katalizator duke tërhequr donatorë dhe organizata të tjera për të kryer punë aq të nevojshme për qytetin. Sa herë që e gjeti të mundur, fondacioni GCDO punoi në partneritet me ente lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Sepse ne besojmë se mbrojtja e trashëgimisë kulturore në Gjirokastrë nuk është çështje vetëm e institucioneve vendore, por edhe një sfidë kombëtare e ndërkombëtare.

Më 2007-ën, GCDO u bë OJQ shqiptare e regjistruar. Dëshiroj të falënderoj donatorët tanë, veçanërisht Packard Humanities Institute dhe Philanthropic Collaborative (New York); po ashtu shprehim mirënjohjen tonë për anëtarët tanë shumë aktivë të Bordit: Profesor Richard Hodges, Daniel Renton, Oliver Gilkes dhe Diana Ndrenika. Falënderojmë gjithashtu partnerët tanë të Qendrës Shqiptare të Arkeologjisë Ndërkombëtare, (Tiranë), Fondacionin “Butrinti” (Londër) dhe shumë e shumë bashkëpunëtorë e mbështetës të tjerë në Gjirokastrë e Tiranë.

Përgëzime të ngrohta i drejtohen ekipit tonë shumë punëtor dhe këmbëngulës të fondacionit GCDO: Elenita Roshi, Alketa Qamo, Enkelejda Roze dhe Lubjana Baoja. Një falënderim i veçantë është për vullnetarët tanë: David Bragg dhe Kate Yarhouse, (tani në Boston të SHBA vullnetarë të Korpusit të Paqes, që na ndihmuan pa masë gjatë gjithë vitit, si dhe për vullnetaren tjetër amerikane Margaret Sheridan. Në vazhdim mund të lexoni një përmbledhje të veprimtarive më kryesore të GCDO-së për vitin 2007.

Sadi Petrela,
Drejtore, GCDO.

1- Zyra për Informim Turistik



Zyra për Informim Turistik (ZIT), një nismë e GCDO-së në partneritet me një biznes lokal u hap në 18 mars 2007, pikërisht në prag të nisjes së sezonit të ri turistik. E vendosur në zonën e Qafës së Pazarit, ajo u bë një pikë ndalese për trafikun turistik në qytet. Gjatë vitit të kaluar (e hapur çdo ditë të javës), qendra mirëpriti dhe ndihmoi mbi gjashtë mijë turistë, duke u ofruar atyre fletëpalosje, harta, guida dhe materiale të tjera që zyra kishte përgatitur dhe shtypur për ta.

Vullnetarët amerikanë të Korpusit të Paqes dhanë një kontribut të madh në krijimin dhe mbarëvajtjen e ZIT. Falenderime të përzemërta dhe për Agjencinë “Old Bazar”.

2 – Qendra e Artizanatit dhe Panairi



Kur Qendra e Artizanatit u përrua më 18 maj, një gjirokastrit tha se ajo ishte “xhevahiri” më i bukur në Qafën e Pazarit. Ai kishte të drejtë! Ajo është vendosur në një ndërtesë karakteristike që u rikonstruktua nga GCDO, posaçërisht për këtë qëllim: të ishte qendra e artizanatit lokal.



Së bashku me Zyrën për Informim Turistik ato kanë sjellë një pamje të re të rrugës që të çon në Kala, një përvojë krejt tjetër për vizitorët, si dhe një interes e veprimtari të re për artizanët vendas. Qendra jo vetëm tregon, duke siguruar të ardhura për ta, por ajo sjell për artizanët gjirokastritë edhe shërbime të trajnimit dhe marketingut jashtë qytetit. Një panair artizanati, që u zhvillua në shtator në zonën e Pazarit, rikrijoi edhe

një herë gjallërinë dhe panoramën shumëngjyrëshe të pazareve të dikurshme në Gjirokastrë. Ky eveniment synohet të përsëritet në shkallë edhe më të gjerë më 2008.

3 – Kampi i restaurimit dhe ai i vullnetarëve

Me aq shumë shtëpi tradicionale të braktisura, që shpesh kthehen në vende për hedhjen e mbeturinave dhe me një nevojë në rritje për pastrim të pjesës së vjetër të qytetit, vullnetarizmi në Gjirokastrë është DOMOSDOSHMËRI. Nismat lokale morën një ngjyrim të ri kur GCDO organizoi një kamp një mujor vullnetarësh me 31 pjesëmarrës nga 14 vende të ndryshme të botës, që erdhën për të dhënë kontributin e tyre për pastrim por edhe restaurim.



Kampi vullnetar u organizua në partneritet me Civil Service International. Vullnetarët rihapën një shteg në parkun rreth Kalasë, pastruan bimësinë e dëmshme nga një skenë e hapur në brendësi të Kalasë (ku më pas sopranoja e njohur Inva Mula dha një koncert), si dhe rreth shtëpisë së Zekateve, një nga kullat më të rëndësishme në Gjirokastrë.

Në shtator GCDO organizoi një kamp restauratorësh në bashkëpunim me OJQ-në suedeze Trashëgimia Kulturore pa Kufinj, ku pjesëmarrësit, 16 studentë nga vende të ndryshme të Ballkanit mësuuan mënyrat tradicionale të ndërtimit. Nën instruktimin e trajnuesve ndërkombëtarë, ata bënë restaurime druri në shtëpinë e Zekateve dhe muri në një ndërtesë karakteristike në Pazar. Këto aftësi janë të domosdoshme për procesin në vazhdim të restaurimeve në qytetin historik dhe po punohet që kampe të tilla të vazhdojnë dhe në të ardhmen.



4- Muzeu për Gjirokastrën



Gjirokastra është qytet-muze që nga viti 1961 dhe e meriton këtë titull, siç meriton të ketë një muze të mirë që të pasqyrojë historinë dhe traditat e saj dhe të luginës së lumit Drino, me pikat shumë të rëndësishme arkeologjike rreth e rrotull.

Në saj të mbështetjes së Philanthropic Collaborative of New York, një projekt për të bërë kërkimin dhe për të

përgatitur paraqitjen e muzeut nisi që në fund të majit 2007 dhe është në vazhdim. Puna është përqendruar në studimin e ndërtesës nga specialistë të Universitetit të Sienës dhe në kërkimin në arkivat e njohura shqiptare për të gjurmuar materialin e nevojshëm për një muze modern. Muzeu mendohet të quhet “Kronikë në gur” dhe do të synojë të bëjë një paraqitje dhe interpretim të qytetit e krahinës si për vizitorët shqiptarë, ashtu edhe ata të huaj. Planifikohet që ky muze të vendoset në galeritë në zemër të Kalasë. Qeveria shqiptare ka caktuar një shumë të madhe për të kryer riparimin e hidroizolimit të kalasë, si pjese e saj në bashkëfinancimin për muzeun e ardhshëm.

5- Kalaja – përmirësimi i përvojës së vizitorëve

Kalaja e Gjirokastrës është një monument i jashtëzakonshëm me një histori rreth 2000 vjeçare. Më 2007, me fonde të Philanthropic Collaborative (New York), GCDO punoi që të përmirësonte përvojën që vizitorët kanë nga vizita në Kala dhe vlerësimin e tyre për të. Në fillim të vitit 2008 nisi puna për vendosjen e disa paneleve shpjeguese për vizitorët, që do vendosen në pika kyçe. Po ashtu ka nisur puna për vendosjen e ndriçimit estetik me konsum të ulët energjie në galerinë e hyrjes në Kala, duke prodhuar energji nga panele diellore, projekt ky që gjithashtu po shkon drejt



përfundimit. Projekti do jetë i pari i këtij lloji në Shqipëri dhe, veç ndriçimit të galerisë përshtypjelënëse të topave, do sigurojë edhe energji të gjelbër e të pandërprerë, si dhe shkurtim të shpenzimeve për mirëmbajtjen e Kalasë. Projekti i ndriçimit financohet nga Packard Humanities Institute, Philanthropic Collaborative dhe PNUD (GEF).

6- Promovimi ndërkombëtar i Gjirokastrës



GCDO ndihmoi në promovimin e Gjirokastrës në shumë ngjarje ndërkombëtare, si në panaiet shumë të rëndësishme të Berlinit dhe Londrës (në sajë të mbështetjes së USAID/EDEM), panairin mesdhetar të turizmit arkeologjik në Paestum të Italisë, në panairin e Tiranës dhe në takimet “Business to Business” në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi. Një vizitë promovuese dhe bashkëpunimi u organizua në qytetin Safranbolu të Turqisë, edhe ky në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.